

Dr. Hysen KOBELLARI

## H. ABDULLAH ZËMBLAKU, FETAR DHE ATDHETAR I SHQUAR

*"I pështyjmë ata qorrë, që tallen me punët fetare;  
Trutharë janë vetë ata, mortja që t'i hajë fare !... "*

Sheh Hafiz Abdullah Zëmbaku

Pas një pune hulumtuese disavjeçare nëpër biblioteka, mjedise familjare, dhe në arkivën shekullore të xhamisë *"Iljaz Bej Mirahori"* të Korçës, arrita të nxjerr mjaft shënime për jetën dhe veprën e Sheh H.A.Zëmbakut.

Kjo figurë shumë e dashur për njerëzit, kudo ku flitet e lexohet shqip, e veçanërisht për besimtarët myslimanë, qëndron denjësisht përkrah mikut të tij të shquar, savantit Hafiz Ali Korça, të cilin, Zëmbaku vetë, e quante vëlla shpirtëror të tij.

Por, ndërsa për H.A.Korçën është shkruar diçka; emrin e tij e mban me krenari një medrese në Kavajë; madje është botuar edhe një monografi për jetën dhe veprën e tij, për H.A. Zëmbakun pak është folur e shkruar. Të gjithë e njohin *"Mevludin"* e tij të famshëm, i cili këndohet në raste festash ose përkujtimesh; njohim mjaft vjersha dhe libra të besimit në gjuhën shqipe, të vlefshëm edhe sot, pas gati një shekulli nga koha kur janë shkruar e botuar.

Hafiz Zëmbaku ishte njeri i ditur, shembull i durimit, model i këmbënguljes në punën për përhapjen e fesë së vërtetë dhe arsimit në shqip, në propagandimin e dashurisë për atdheun, diturinë e shkencën, për të vërtetën, paqen dhe mirësinë...

Hafiz Abdullah Zëmbaku e quante veten me krenari *"Shërbëtor i Kombit Shqiptar"* dhe *"Misionar dhe mësues i Fesë Islame"*. Këto cilësime qëllimlarta ai u përpoq t'i përmbushte me punë të palodhur gjatë gjithë jetës së tij, duke shkruar e botuar mbi 30 libra, duke i rënë kryq e tërthor qyteteve e fshatrave të atdheut, për të predikuar falas besimin e vërtetë, diturinë, atdhetarinë, paqen, të vërtetën dhe progresin.

Hafiz Zëmlaku është ndër të parët hartues dhe organizatorë të botimit të librave në gjuhën shqipe me përmbajtje fetare. Librat shkruheshin në gegërisht dhe toskërisht dhe shpërndareshin falas gjatë veprimtarive që organizonte shpesh H.A.Zëmlaku në veri ose në jug të vendit. Në librat e tij gjenden lista të gjata me të dhëna të hollësishme për ata që mbështetën për këto botime, të gjithë besimtarë zemërbardhë e dashamirës.

Duke zotëruar disa gjuhë të huaja, si: arabisht, turqisht, persisht, sllavisht, etj., ai u formua me një kulturë të plotë jo vetëm fetare, por edhe letrare e shkencore.

Bashkëpunoi me revista dhe gazeta të kohës, si me revistat “Zani i Naltë”, “Kultura Islame”, “Njeriu”, etj., ku botoi shkrime të ndryshme. Përktheu vepra fetare, filozofike e mistike, disa prej të cilave mundi t’i shtypte e t’i shpërndante.

Është ndër bejtexhinjtë e fundit, të cilët poeti ynë kombëtar Naim Frashëri i ka vlerësuar, shumë.

Po përse vallë për Sheh Hafiz Abdullah Zëmlakun kanë heshtur kaq padrejtësisht jo vetëm studiuesit dhe hulumtuesit, por edhe klerikët dhe drejtuesit e institucioneve fetare dje dhe sot?!

Mbase kjo ka ndodhur ngaqë Sheh Abdullahu i përkiste një tarikati të veçantë. Siç thotë për veten në librin “Bilbili Paq”, përmbledhje e vjershave më të mira, viti 1940 ai ishte: “Misionar Islam dhe Mësues i Fesë Islame për shpirt (shëtitës); Halifat i *Tarikatit Nakshi dhe Hajati*; autor i librave fetare shqipe. Sheh Hafiz Abdullah Sëmlaku (Fatih), kishte dalë nga medrese e naltë Darulhilafe dhe nga Shkolla e Naltë Darulfununi Sherijje (Universitete) e Stambollit.” Siç duket nga këto tarikate, sot ka pak ose aspak njohës, përkrahës e ndjekës.

Sheh Zëmlaku është ndoshta bejtexhiu i fundit, i cili u përpoq të kuptonte rrezikun e hyrjes së dendur të fjalëve turke, arabe, persiane në gjuhën shqipe, të pakuptimta për popullin e thjeshtë dhe rrezikun e përzjerjes së gjuhëve deri në përçudnim. (Xh. Spahiu, “Perla”, 2005/1 f.17)

Hytbet e mbajtura nga H.A.Zëmlaku janë model i shkëlqyer i zberthimit të Kuranit Famëlartë dhe Haditheve të Pejgamberit (a.s.), shembull arsytimi dhe gërshetimi me problemet e kohës dhe gjendjen faktike të jetës te ne. Ai propagandonte harmoninë fetare në vendin tonë, duke porositur besimtarët që të respektojnë

fenë e tjetrit në të drejtë të tyre dhe duke adhuruar fenë e vet, duke u thelluar në Librin e Shenjtë e Praktikën Pejgamberike...

Edhe sot e kujtojnë Hafizin e shquar për zërin melodioz dhe të ngrohtë, për fjalët e zgjedhura nga burimi shqiptar, për diturinë e pasosur që rridhte nga natyra e fesë së vërtetë dhe e kërkimeve të tij të mundimshme nëpër libra, për disiplinën e natyrshme që buronte nga karakteri i tij shembullor. Me bagazhin e dijeve që zotëronte, ai ishte mjaft i avancuar krahasuar me nivelin kulturor të njerëzve, ku kishte mjaft analfabetë, gjë për të cilën ai dëshpërohej shumë dhe luftonte në praktikë.

Hafizi ka agjëruar shumë, ka kryer vepra të shumta bamirëse dhe ka qenë shembull në jetën familjare dhe shoqërore.

Disa nga Hytbet e tij kryesore janë botuar nëpër libra të veçantë dhe mund të lexohen edhe sot me ëndje e kërshtëri.

Hafiz Abdullah Zëmbllaku ishte edhe një mësues i shquar i gjuhës shqipe. Ka ngritur me qindra kurse verore e dimërore kundër analfabetizmit nëpër qytete e fshatra të ndryshëm të vendit, në një kohë kur pjesa dërrmuese e popullsisë nuk dinin shkrim e këndim dhe jetonte në kushte të një varfërie të madhe..

Kurset i organizonte falas, duke siguruar shpeshherë për pjesëmarrësit edhe libra, fletore e lapsa për punë mësimore. Në këto kurse mësohej shqip, fitohej kulturë fillestare fetare, mësoheshin elemente të shkencave të kohës, dhe merrej edhe një edukatë morale e qëndrueshme.

Për të gjitha këto cilësi dhe të tjera, që janë të njohura nga bashkëkohësit e H.A.Zëmbllakut, kjo figurë duhet vlerësuar ashtu siç e meriton.

### **Pak fjalë për paraardhësit**

Hafiz Abdullah Zëmbllaku u lind dhe u rrit në një familje me tradita të lashta atdhetare dhe fetare islame. Gjyshi dhe babai i tij kanë qenë intelektualë të njohur dhe kanë studiuar nëpër shkolla të famshme të kohës së tyre, brenda e jashtë vendit.

Ndërkohë ata nuk e kanë ndarë diturinë e fituar nga dashuria për atdheun dhe gjuhën shqipe, gjuhën e nënës. Nëna e Hafizit quhej Aishe Mulla Hysein Babani dhe rridhte nga një familje me ndjenja fetare dhe atdhetare. Gjyshi i H.A.Zëmbllakut quhej Sheh Hasan Zëmbllaku dhe kishte kryer shkollë fetare.

Babai i Hafizit quhej Salih Hulusi dhe ka shërbyer për 30 vjet si mësues shkolle fillore, e quajtur ndryshe Ruzhdie, në disa qytete të Shqipërisë, si në Bilisht, Durrës, Ersekë, Krujë, etj. Po ashtu ai ka dhënë mësim edhe jashtë vendit, si në Prilep, Allosojë, Ankorë etj.

Në gjuhët turke, arabe e persiane ai kishte arritur një nivel të lartë përvetësimi dhe lexonte nga origjinali vepra të karakterit fetar, filozofik, shkencor dhe letrar. Po ashtu edhe në gjuhët europiane, sllave e greke. Këtë nivel e trashëgoi edhe Abdullahu i vogël, duke ndenjur vazhdimisht pranë të atit dhe duke marrë mësimet e para dhe kulturën fillestare.

I ati i Hafizit vdiq në vitin 1936 në moshën 77- vjeçare, në qetësi dhe paqe, kur i biri, Abdullahu ishte në kulmin e punës së vet fisnike fetare e atdhetare.

### Vitet e para të jetës dhe arsimimit

Hafiz Abdullah Zëmplaku u lind në qytetin e Bilishtit në vitin 1891. Menjëherë familja u vendos në fshatin Zëmplak, rrëzë fushë - kodrës, në të djathtë të rrugës Korçë - Bilisht, me pamje nga hyrja e fushës së Devollit. Ishte fëmijë i urtë e shumë i zgjuar, plot nur.

Kishte dëshirë të meditonte gjatë dhe të dëgjonte me ëndje të atin kur falej dhe këndonte sure nga Kurani i Shenjtë. I pëlqente të thurte vargje e të bënte vjersha të shkurtra, sipas modeleve të librave që i lexonin prindërit dhe tëbejteve që qarkullonin në atë kohë, disa prej të cilave kishin thekse satire dhe ironie, ku fshikulloheshin vese të njerëzve dhe të zakoneve shoqërore e familjare të kohës.

Mësimet e para fillore dhe të mesme të asaj kohe (e mesmja quhej “qytetëse”), Abdullai i vogël i mori prej babës së vet, Sali Hulusiut, në kushtet e shtëpisë. Mësoi përveç gjuhës shqipe edhe bazat e turqishtes, arabishtes e persishtes.

Pastaj i vazhdoi studimet teologjike në Medresenë e Prilepit, atje ku ka shërbyer edhe i ati, si mësues Ruzhdije.

Në vitin 1910, në moshën 19- vjeçare, i mbaroi këto studime dhe u njoh gjithashtu edhe me gjuhët sllave. Sakaq u nis për të konkurruar në universitete të Stambollit në Turqi, kryeqendër e Perandorisë Osmane të asaj kohe, qendër e madhe diturie, qeverisjeje, qytetërimi, ku gëlonin virtyte dhe vese të çfarëdollojshme.

Dëshironte të vijonte studimet e larta filozofike dhe fetare dhe u pranua në degën Ilahijat të iniversitetit. Medreseja e Lartë ku ai kreu studimet quhej Darulhilafe dhe shkolla e lartë e Stambollit quhej Darulfununi Sherijje (Universitete) (marrë nga shënimi në Mevludi Paq, viti 1940 ). Aty mori vlerësimet më të larta në teori e praktikë.

Tregojnë se në përfundim të studimeve teorike e praktike, studentët hoxhallarë të rinj i çuan në një pyll. U dhanë nga një pulë të gjallë dhe nga një thikë dhe u thanë: “Therini, duke mos ju parë kush!” Të rinjtë u shpërndanë nëpër pyll dhe secili e kreu punën e ngarkuar, përveç 5 vetave, midis të cilëve edhe Abdullahu. Kur i pyetën përse nuk kishin bërë si të tjerët, A.Zëmbllaku shpjegoi në emër të të pestëve: “Nuk mundëm, sepse Allahu shikon gjithçka !” Atëhere drejtuesit e shkollës i vlerësuan me nota maksimale të pesë të rinjtë në fjalë, midis tyre, të parin H.A.Zëmbllakun.

Sapo përfundoi studimet e larta dhe u diplomua shkëlqyeshëm, për shkak të fillimit të Luftës së Parë Botërore e, u mobilizua nën armë nga shteti osman). Pasi shërbeu për disa kohë si oficer rezervist, u lirua dhe u kthye në atdhe, pranë familjes, plot ëndrra të bukura dhe plane për të ardhmen.

### **Misionar i përkushtuar dhe mësues i palodhur**

Ishte koha kur vendi kishte nevojë për njerëz të mësuar e të përkushtuar dhe djaloshi i devotshëm dhe i përgatitur më së miri duhej t’i shërbente popullit të tij. Për disa vjet, Hafiz Abdullahu, punoi si imam hatib në fshatin Zëmbllak. Aty i hyri punës për të zgjeruar njohuritë e tij fetare, shkencore e kulturore, duke lexuar pa u lodhur literaturë të vjetër dhe bashkëkohore, nga botimet që gjendeshin pranë familjes dhe në libraritë e Korçës, Tiranës, madje porositi literaturë edhe jashtë vendit.

Në vitin 1921, me propozim të Ministrisë së Arsimit u emërua mësues në fshatin Kuç dhe Belorta të Korçës. Këto fshatra ndodhen 5-6 km larg fshatit Zëmbllak, përgjatë rrugës nacionale Korçë - Kapshticë, në të djathtë të saj. Rrugën Hafizi e bënte më këmbë.

Në këtë detyrë fisnike punoi vetëm tre vjet, pastaj dha dorëheqjen, për t’u përkushtuar tërësisht në veprimtari fetare dhe për të praktikuar arsim të lirë dhe fe pa pengesë.

Tashmë, H.Abdullahu, e ndjente veten të përgatitur për të nisur punën intensive në lëmin e përkthimeve dhe botimit të librave fetare dhe shkencore në gjuhën amtare, për të cilat kishte mungesa të mëdha dhe kërkesa të vazhdueshme anembanë vendit, madje edhe në diasporë. Hafizi angazhohej vetëm 6 muaj në detyrën e tij si imam në fshatin Zëmlak, ndërsa gjysmën tjetër të vitit linte një zëvendës të përgatitur nga vetë ai dhe shëtiste në të gjithë vendin.

Ai i binte kryq e tërthor atdheut, nga Jugu në Veri dhe në Shqipërinë e Mesme, duke dhënë mësim, duke shpërndarë literaturë e duke ndihmuar e inspektuar të gjitha shkollat fetare islame të vendit. Për këtë ai kishte edhe autorizimin e Komunitetit Mysliman Shqiptar dhe të Ministrisë së Arsimit. (Shënimet në ballinën e prapme të librit *"Bilbili Besëtar"*, viti 1936).

Kryeministri Mehdi Frashëri, mik i vjetër i Hafizit, i ka premtuar: "Hafiz Zëmlaku ligjërisht është i lirët të mësojë Fe dhe për këtë çështje do t'i them edhe Ministrit të Arsimit, që të mos pengohet nga arsimitarët." (Marrë nga libri *"Bilbili shpirtnor ose Misionarët myslimanë"*).

Në punën e tij misionare, që nga viti 1936, merrte edhe vajzën e tij 8- vjeçare, Hedijen, e cila u bënte mësim vajzave, duke u mësuar atyre vjersha, këngë dhe ilahi, lojra të ndryshme, shkrim e këndim shqip e arabisht.

Disa herë iu bë ftesë për të kryer detyrën e Myftiut në Korçë dhe Kavajë, por ai e shtynte përgjigjen, duke refuzuar, për të qënë i lirë në veprimtarinë e tij të madhe e të palodhura si përkthyes e botues, në shërbim të mbarëvajtjes së fesë islame dhe të arsimit shqip.

Si rezultat i një pune të madhe këmbëngulëse e të gjatë në kohë me librin dhe botimet, H.A.Zëmlaku, ia doli mbanë të përkthejë, hartojë, shkruajë dhe botojë mbi 30 libra origjinalë dhe të përshtatur, të cilët ishin shumë të kërkuar dhe që u ribotuan disa herë, për të qarkulluar brenda e jashtë vendit.

Në punën e tij fisnike dhe të dobishme e ndihmoi shumë edhe miqësia që pati me të palodhurin dijetar dhe misionar, të paharruarin Hafiz Ali Korça, të cilin e quante vëlla në shpirt dhe besim. Ai pati bashkëpunim edhe me intelektualë të tjerë të rajonit dhe të vendit, myslimanë ose jo, si edhe me dijetarë të huaj.

Hafiz Abdullah Zëmlaku ia doli të bëhej njëri nga intelektualët më të spikatur dhe më të përkushtuar të kulturës shqiptare, fesë islame dhe arsimit shqip, duke fituar një reputacion të madh brenda e jashtë vendit. Ai ka kryer një punë të madhe fisnike si misionar fetar dhe përhapës i arsimit shqip edhe jashtë trojeve shtetërore, kudo ku banonin shqiptarë, si në Kosovë, Maqedoni, Çamëri, kudo ku flitej gjuha e lashtë dhe e bukur shqipe.

Edhe pas çlirimit, veprimtaritë fetare dhe arsimore i vazhdoi, me gjithë kushtet e vështira të kohës dhe pengesat e monizmit. Është dënuar dy herë me burg nga gjykatat komuniste për motive politike.

H.Avdullahu ka qenë i internuar për disa muaj në Krujë edhe nga qeveria e Zogut, me vetë porosinë e Mbretit, për shkak se në një libër pati shkruar: "Ti moj Nëna Mbretëreshë,/ k'to Komuna pse i deshe ?..." Tregojnë, se pas internimit, Mbreti e thirri në Tiranë, ku patën një bisedë kokë më kokë për probleme të ndryshme. Monarku i dha pastaj një shpërblim për familjen dhe Sheh Abdullau u kthye sërish në fshat për të vazhduar punën e tij.

### **Lista e librave të botuar**

Janë listuar 30 libra të botuar nga Hafiz Abdullah Zëmlaku, por punët e tij fetare, letrare e kulturore kanë përmasa më të gjera se kaq. Kanë mbetur shumë botime të tjera të pahasura deri tani nga ana ime dhe e bashkëpunëtorëve të mi, po edhe shumë dorëshkrime pranë familjes e gjetiu.

Më poshtë, titujt e librave të botuar, të cilat janë krijime origjinale, përkthime, përshtatje, etj.:

1. Mevludi Sherif
2. Pesë Kasidetë e Imamllarëve
3. Hydbe me 50 këshilla fetare
4. Muhamedia (Jeta e Pasosur )
5. Bilbili I - Abetare me disa jetëshkrime
6. Bilbili II - Enami Sherif në shqip
7. Bilbili III - Histori e Shenjtë
8. Bilbili IV - Hadithi Sherif (Fjala Profetike )
9. Bilbili V - Sheriati Muhamedie
10. Bilbili VI - Ëndërrëfenjëse
11. Bilbili VII - Shqiponja besëtare

12. Bilbili VIII- Fëllëza kombëtare
13. Bilbili IX - Pëllumbi
14. Bilbili i ri i Prillit
15. Bilbili i ri i Hazreti Kuranit
16. Fletore Islame
17. Amaxhyz me gërma shqip
18. Tebereqe xhyzi
19. Bilbili i Hënës - (Hydbe e re )
20. Bilbili Besëtar - (I madh )
21. Bilbili shqiptar - Dheshkronjë e Shqipërisë
22. Bilbili besëtar - (I vogël )
23. Bilbili shpirtnor
24. Bilbili i veriut (Mevludi gegërisht )
25. Bilbili faqebardhë
26. Bilbili i Parajsës
27. Bilbili 10 Stërgu - Tesfiri 1001 qelim
28. Kurani i Shenjtë me gërma shqipe
29. Çelsi i Parajsit
30. Sahatnameja, Marifetnameja dhe vepra të mistikut Syherverdi,etj.

Pa bërë komente dhe analiza të veçanta dhe të thelluara për ndonjë vepër të Sheh H.A.Zëmbllaku, mund të themi se ato janë frut i një pune të palodhur dhe i një kulture të gjerë e të gjithanshme të shkruarit, frut i njohjes së thelluar të kulturës së shkruar të vendeve të tilla, si Turqia, Irani, vendet perëndimore, etj. Po ashtu, ato tregojnë për një njohje të mirë të kulturës, gjuhës dhe zakoneve të popullit të tij, si dhe për një lidhje të ngushtë të veprimtarive fetaro-arsimore me gjendjen konkrete dhe hallet e mëdha të njerëzve të kohës.

### **Hafiz Abdullah Zëmbllaku dhe Shkodra**

Nuk është e rastit që H.A.Zëmbllaku i ka shkruar një pjesë të veprave të tij edhe në dialektin gegërisht, të cilin e vlerësonte shumë. Ai ka punuar shumë edhe në Veri të Shqipërisë duke kryer shërbime, siç thotë ai vetë "... për Hatër të Zotit, jo për hatër të rrogës".

Shkodra është vendi ku ka punuar më shumë Hafizi, sidomos në periudhën pas mbarimit të shkollave, në verë. "Mësimi shqip

plotësohet për pak ditë dhe drita e besimit rrënjohet përjetë “, - thodhte ai për këto kurse verore.

Në vitet '30 të shekullit të 19-të Shkodra kishte 45 xhami, ndërsa shkodranët çmoheshin përgjithësisht si njerëz fetarë e kombëtarë. Në 10 xhamitë kryesore, si në Rus, Guras, Mbret, etj., Hafiz Abdullahu organizonte në verë shkolla të mësim - besimit. Fëmijët dhe të rinjtë, vajza e djem, mësonin një javë, ku mblidheshin në shoqëri, merrnin libra e fletore falas dhe mësonin faljet sipas rregullave përkatëse.

“Shkodra fetare - Meka e Shqipërisë; Shkodra e madhe - Stambolli i Shqipërisë “, shkruan për këtë qytet me gëzim e krenari H.A.Zëmbllaku. Duke përshkruar misionin e tij fetar të vitit 1936 në të gjithë Shqipërinë, ai thekson padijen dhe nivelin e ulët përgatitor të klerit mysliman në bazë.

“Në botë ca njerëz turpërohen nga rob, ca nga Zoti, po ca presin vetëm rrogat “, “Në Vlorë ka xhami, po si kafazi pa bilbil - s’ka xhemmat... Peshku, kur qelbet nga koka, zë qelbet edhe nga bishti”, - shkruan midis të tjerash Hafizi me theks kritik në librat e tij..

Interesante janë mendimet e H.Zëmbllakut për të dy dialektet kryesore në vendin tonë. Ai shkruante: “Për me shkurtim gradon Gegnishtja, për me hollësi na duket Toskërishtja, e cila rreh çeka në majë të kokës. Gegnishtja më tepër tingëllon në hundë... Në gjuhën tonë, po të mos përdoren fjalë të huaja, të dy palë dialektet, që janë motra, do të ruhen dhe do të njihen përgjithësisht...”

### **Vitet e fundit të jetës**

H.A.Zëmbllaku nuk është marrë shumë me politikë, por edhe indiferent nuk ka qëndruar ndaj saj. Parapëlqente një monarki të tipit perëndimor, ku liria të harmonizohej mirë me diturinë dhe edukatën fetare. Ai agjëronte gjithë vitin dhe bënte ibadet (falej) vazhdimisht, sidomos në namaz nate.

Ai e kuptonte mirë politikën, ndonëse nuk ju kushtua shumë asaj. Mbështeste dhe frymëzonte forcat politike të asaj kohe që e urrenin vërtet pushtuesin, pa braktisur traditën dhe pa qenë skllëvër të idhujtarisë bolshevike. Miqtë e tij nga Zëmbllaku ishin rreshtuar nëpër aradhat atdhetare të traditës, të cilët nuk kishin lidhje me idetë e huaja. Hafizi shpirtërisht i përkrahu ata.

Për rrjedhojë ai u pa me sy jo të mirë nga regjimi i ri monist, që doli pas luftës. Megjithatë Shehu mbeti në sytë e popullit ashtu siç ishte në të vërtetë, i urtë, i ditur e i drejtë, durimtar e atdhetar veteran. Veprimtaria e madhe atdhetare, librat e shumtë të shkruar e botuar dhe jeta e tij shembullore e kanë bërë figurën e tij të pavdekshme brez pas brezi dhe një nga figurat më të shquara të fesë islame dhe arsimit në trojet shqiptare.

Pas çlirimit të vendit, për shkak të qëndrimit të regjimit të ri monist ndaj fesë dhe klerikëve, që ishte një qëndrim përbuzës dhe denigrues Hafiz Zëmbllaku, si edhe klerikë të tjerë të vendit, vuajtën pa masë. Për motive politike dhe fetare, Hafizi u dënua dy herë nga gjykata e atëhershme.

Ai nuk lejohej të qarkullonte lirshëm në të gjithë vendin si më parë, nuk i lejohej të botonte libra, si dikur. Kështu që veprimtaria e tij fetare, letrare e shkencore u rrudh, u përqëndrua brenda mureve të shtëpisë dhe në xhaminë e fshatit Zëmbllak.

Ai shihte me keqardhje se si brezi i ri po e braktiste besimin fetar, po shthurej moralisht, nuk po nderohej pasuria, puna e tjetrit, njerëzit po vetëflijojeshin në arenën e madhe të luftës së klasave, vendi po izolohej gjithnjë e më shumë nga miqtë e dikurshëm nëpër botë dhe në moçalin ideologjik të kohës po lulëzonte ateizmi, literatura bolshevike dhe përndjekja e intelektualëve, për të cilën kishte shkruar dikur me tone alarmi Hafiz Ali Korça.

Hafiz Abdullah Zëmbllaku vdiq më 31 gusht 1960, i përcjellë me respekt dhe mallëngjim nga mijëra besimtarë, nga të afërm, shokë e miq, nga vendlindja dhe diaspora.

### Përfundime

-Përpara se të jetë poet dhe shkrimtar, Hafiz Abdullah Zëmbllaku ishte dhe mbetet misionar fetar dhe atdhetar i shquar, njeri i rrallë për nga veprimtaria, vetitë e larta që e karakterizojnë dhe karakteri i tij i veçantë. Ai ia kushtoi gjithë jetën dhe pasurinë e vet çështjes së fesë, gjuhës shqipe, mbarëvajtjes së jetës shpirtërore të popullit të vet dhe përparimit të atdheut.

Veprat, jeta dhe veprimtaria misionare - atdhetare e H.A.Zëmbllakut duhet të studiohet dhe hulumtohet më hollësisht dhe më me seriozitet e përkushtim nga studiuesit tanë të këtyre fushave. Ato janë një shembull përkushtimi, durimi, kulture dhe

devotshmërie që duhen çmuar, për të qenë shembull i brezave të sotëm dhe për ata që do të vijnë.

Për të përjetësuar emrin dhe veprën e H.A.Zëmlakut, këtë vit, janë organizuar veprimtari përkujtimore - shkencore për nder të tij dhe veprës që la pas. Ai u nderua me titullin "Qytetar Nderi" nga Komuna Pojan në Korçë, nën kujdesin e Kryekomunarit Alfred Berberi.

Medreseja e Korçës mban emrin e nderuar të Sheh Hafiz Abdullah Zëmlakut.

Mbase një monografi e posaçme do të ishte e vlerësuar dhe e mirëpritur prej të gjithëve.

### **Burimet:**

- Gjithë literatura e botuar nga H.A.Zëmlaku, e cila ndodhet në Bibliotekën "*Thimi Mitko*" në Korçë.
- Revista "*Njeriu*", nr.2(14), gusht 1943 f.16, shënimi.
- "*Bilbili i Prillit*", prill 1928.
- Revista "*Zani i Naltë*" nr.8, viti 1938, f.248.
- "*Mevludi Paq*" - Nuri Ahmedia, viti 1931, botim i dytë.
- "*Bilbili Paq*", viti 1940, Përmbledhje vjershash më të mira.
- "*Bilbili Shpirtnor*" viti 1936, f. 4, 7, etj.